

RREGULLORJA PËR PËRFAQËSUESET E KOSOVËS

Në bazë të nenit 25 pika 14 të Statutit të Federatës së Basketbollit të Kosovës, Bordi i FBK në mbledhjen e vet të mbajtur më 27.09.2011, aprovoi:

RR E G U L L O R E N

E PËRFAQËSUESEVE TË BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

1.-DISPOZITAT THEMELORE

Neni 1

Me rregulloren e Përfaqësueseve (ne tekstin e mëtejshëm: rregullorja), përcaktohen:

- Kategoritë dhe emërtimet e Përfaqësueseve,
- obligimet e klubeve përballe Përfaqësueseve,
- obligimet e lojtareve dhe lojtareve përballe Përfaqësueseve,
- Drejtorit, përzgjedhësve dhe shtabet profesionale te Përfaqësueseve,
- Delegacionet e FBK dhe përfaqësuesit zyrtare te Përfaqësueseve

Neni 2

Përfaqësueset te basketbollit paraqesin Kosovën, Federatën e Basketbollit te Kosovës, (ne tekstin e mëtejshëm: FBK) dhe sportin Kosovar ne garat dhe paraqitjet ndërkombëtare.

Neni 3

Pjesëmarrja ne Përfaqësueset e basketbollit është nderë dhe obligim i secilit basketbollist dhe basketbolliste (ne tekstin e mëtejshëm lojtar), secilit anëtar te shtabit profesional, si dhe çdo anëtar dhe anëtareje te FBK-se.

Është obligim i secilit anëtar te FBK qe te siguroje kushte optimale për pune dhe suksese te Përfaqësueseve. Në veprimtarinë e FBK suksesi i Përfaqësueseve është ne plan te pare.

Neni 4

Me emërtimin Përfaqësuese merret parasysh:

- 1.-Përfaqësuesja e seniorëve – meshkujt
- 2.-Përfaqësuesja e te rinjve - meshkujt
- 3.-Përfaqësuesja e juniorëve – meshkujt

- 4.-Përfaqësuesja e kadetëve - meshkujt
- 5.-Përfaqësuesja e kadetëve të rinj,- meshkujt,
- 6.-Përfaqësuesja e senioreve – femrat,
- 7.-Përfaqësuesja e juniorëve – femrat,
- 8.-Përfaqësuesja e kadetëve – femrat,
- 9.-Përfaqësuesja e kadetëve të reja,

FBK sipas nevojës mund të themelojë edhe Përfaqësuesen të tjera (mesdhetare, studentore, ushtarake, policore etj). Skuadra e klubit,qytetit apo e regjionit nuk mund të garojë me emrin e Përfaqësueses.

Neni 5

Ngjyrat e fanellave dhe veshmbathjeve janë kaltër, verdhë dhe bardhë. Në pjesën e epërme të gjoksit, në anën e majte gjendet stema shtetërore e Kosovës.

Neni 6

Përfaqësuesen e përbejnë lojtarët e përzgjedhur,përzgjedhësi,Drejtori dhe anëtarët e shtabit profesional të Përfaqësueses.

Edhe gjyqtari në rast se është parapare në rregulloret e FIBA-se mund të bëhet pjesë e Përfaqësueses,ose me ftesën e organizatorit të turneut apo turneve.

Në rast se gjyqtari është anëtar i Përfaqësueses,sipas alinesë paraprake të këtij neni, ka të drejta dhe obligime të anëtarëve të Përfaqësueses (shpenzimet,akomodimi, paisjet sportive etj). Gjyqtaret (për turne dhe ndeshjet miqësore) i cakton Bordi i FBK në bazë të propozimit të Shoqatës së gjyqtareve të basketbollit të Kosovës,përpos në rastet kur ata i cakton FIBA.

II.- OBLIGIMET E KLUBEVE

Neni 7

Obligim i çdo klubi,amator apo profesional,qe për zbatimin e programit të aktiviteteve të Përfaqësueses, të ve në dispozicion të FBK të gjithë lojtarët e përzgjedhur si dhe tërë potencialin Professional dhe potencialin tjetër në arritjen e sukseseve të Përfaqësueseve.

Neni 8

Me rastin e miratimit të sistemit të garave në të cilin marrin pjesë klubet profesionale, FBK udhëheq me interesat e të gjitha Përfaqësueseve shtetërore nga neni 4 I kësaj rregulloreje.

Me rastin e propozimit nga alineja paraprake, shoqata e klubeve profesionale udhëhiqet me interesat e njëjta të Përfaqësueseve, për çka do të ketë kujdes edhe shoqata e basketbollisteve profesioniste me dhënien e mendimit për sistemin e garave.

Neni 9

Obligim i secilit klub, amator apo profesionist, është që t'i përmbahet kalendarit të miratuar, të cilin e ka përpiluar Bordi i FBK.

Neni 10

Kandidatit të përzgjedhur në Përfaqësuese, klubi është i obliguar që të mundësojë pjesëmarrjen në përgatitjet dhe në lojërat e Përfaqësueses.

Neni 11

Klubi është i obliguar t'i mundësojë veprimtarëve profesionist trajnerëve, mjekëve, fizioterapeutëve) të marrin pjesë në realizimin e programit të aktiviteteve të Përfaqësueseve, kur këtë e kërkon ndonjëri nga përzgjedhësit e Përfaqësueseve.

Neni 12

Nëse paraqitja zyrtare e klubit përputhet me obligimet e Përfaqësueses në të cilin është zgjedhur lojtari i atij klubi që ka të drejtë të kërkojë shtyrjen e ndeshjes së vet (për kupë apo kampionale) dhe atë për tërë kohën sa lojtari është me Përfaqësuesen. Lojtarit të përzgjedhur në Përfaqësuese nuk i lejohej që në kohën e aktiviteteve të Përfaqësueses të luaj nëpër turne me klubin e vet, përpos në raste kur këtë e lejon përzgjedhësi i Përfaqësueses.

Neni 13

Nëse për mospjesëmarrjen apo vonesën e lojtarëve ose veprimtarit profesional në përgatitjet e Përfaqësueses përgjegjës është klubi, do të dënohet klubi në shumën prej 1000 € deri në 5000 €, e nëse vërtetohet se kjo është bërë ekskluzivisht me fajin e klubit, ndaj klubit mund të merren edhe masat me të rrepta disiplinore.

OBLIGIMET E TRAJNERËVE:

Trajneri i klubit të caktuar nga i cili është i ftuar lojtari i asaj skuadre për përfaqësuese - trajneri i skuadrës nga i cili vjen lojtari i ftuar duhet që: të ketë bashkëpunim me Përzgjedhësin e Përfaqësueses, të realizoj planprogramin kur e kërkon Përzgjedhësi, të kryej stërvitje shtesë me

lojtarin e Përfaqësueses kur atë e kërkon Përzgjedhësi, mos t'i bëhet pengesë lojtarit që të shkoj në stërvitje me përfaqësuese. Në rast të pospërmbytjes së kësaj rregulloreje pason dënimi për trajnerin e skuadrës në fjalë nga minimumi 6 deri 12 muaj moskryerje të detyrës si trajner i skuadrës dhe nga 200 deri 500€ dënim në të holla.

III.-OBLIGIMET E LOJTARËVE

Neni 14

Për Përfaqësuesen e Kosovës mund të angazhohen shtetasit e Kosovës dhe lojtaret me dyshtetësi ne përputhje me rregulloret e organizatës ndërkombëtare te basketbollit (FIBA).

Neni 15

Pjesë e Përfaqësueses nuk mund të jetë lojtari i suspenduar,i dënuar ose qe kundër tij zhvillohet procedurë disiplinore. Në raste te veçanta, me kërkesën e përzgjedhësit, organi i cili zhvillon procedurën disiplinore, mund ta heq suspendimin, gjegjësisht, ta shtyje procedurën disiplinore.

Neni 16

Lojtari i Përfaqësueses te Kosovës,është i obliguar ta përfaqësoi Kosovën dhe basketbollin e Kosovës ne boten e jashtme.

Lojtari i Përfaqësueses te Kosovës është i obliguar te kontribuoj më tërë dijen dhe angazhimin e vet maksimal për arritjen e rezultateve sa me të mira te Përfaqësueses, dhe te aplikoj rregullat e basketbollit dhe rregullat e sjelljeve “FAIR-PLAY”.

Neni 17

Ne përgatitjet dhe lojërat e Përfaqësueses te Kosovës, lojtari i përzgjedhur është i obliguar t'i përmbahet udhëzimeve dhe urdhëresave për stërvitje, lojëra, qëndrimin ne përgatitje, udhëzimeve për shfrytëzimin e pajisjeve, udhëzimeve për ushqim dhe barna, si dhe udhëzimeve tjera te cilat i parashtron shtabi teknik dhe përzgjedhësi i Përfaqësueses.

Neni 18

Pas përcaktimit te listës se lojtarë(e)ve për kandidat të ndonjërës Përfaqësuese, Drejtori i Përfaqësueses, me shkrese fton lojtaret e përzgjedhur për bashkëpjesëmarrje në punën e

Përfaqësueses. Ftesa me shkrim i dorëzohet lojtarit përmes klubit ose drejtpërdrejt në adresën e tij të banimit.

Lojtarët mund të njoftohen edhe përmes adresës zyrtare të Federatës së Basketbollit të Kosovës e poashtu edhe nëpërmjet e-mailit personal të lojtarëve.

Neni 19

Ftesa për lojtarin përmban programin e përgatitjeve dhe lojërave, kohën dhe vendin e grumbullimit, si dhe obligimet e lojtarit.

Neni 20

Lojtari është i obliguar t'i përgjigjet ftesës për përgatitje dhe lojëra të Përfaqësueses. Me marrjen e ftesës për pjesëmarrje në Përfaqësuese krijohen obligimet për lojtarin dhe klubin e tij.

Neni 21

Abstenimin për pjesëmarrje në Përfaqësuese mund të paraqitet vetëm për shkaqe të arsyeshme. Shkaqe të arsyeshme konsiderohen : rastet e vdekjes ose sëmundjes së rëndë në familje, lëndimi i rëndë ose sëmundja e lojtarit. Shkallën e lëndimit ose të sëmundjes së lojtarit e përcakton mjeku i Përfaqësueses ose komisioni mjekësor i caktuar nga FBK.

Neni 22

Ne rast të abstenimit, lojtari i ftuar është i obliguar që me shkrim ta njoftojë përzgjedhësin përmes Drejtorit të Përfaqësueses. Abstenimin me shkrim, në afat prej 48 orësh nga pranimi i ftesës, mund ta paraqesë edhe klubi në vend të lojtarit.

Nëse rrethanat për abstenim krijohen pas marrjes së ftesës, lojtari gjegjësisht klubi janë të obliguar që me shkrim menjëherë ta njoftojnë përzgjedhësin përmes Drejtorit të Përfaqësueses.

Neni 23

Lojtari i cili abstenon nga pjesëmarrja në Përfaqësuese për shkak të lëndimit ose sëmundjes, është i obliguar që këtë ta paraqesë me shkrim, kurse bashkë me shkresën duhet të paraqesë tërë dokumentacionin mjekësor lidhur me lëndimin ose sëmundjen e tij.

Nëse mjeku ose komisioni mjekësor i Përfaqësueses vlerësojnë se lojtari duhet kontrolluar nga ana e tyre, lojtari është i obliguar t'i përgjigjet ftesës për kontrollim të mëtejshëm. Në

rast se lojtari nuk i përgjigjet ftesës për kontrollim të mëtejshëm do të konsiderohet se mungesa e tij është e paarsyeshme.

Neni 24

Ndaj lojtarit i cili pa arsye vonohet ose nuk i përgjigjet ftesës për grumbullim, ose që gjatë përgatitjeve me veprimet e tij dëmton autoritetin e Përfaqësueses, do të iniciohet procedure disiplinore në komisionin disiplinor të FBK.

Ne raste të dyshimit të bazuar për kundërvajtje për të cilën me rregullore disiplinore të FBK parashihet dënimi me mos lojë deri në një vit, përzgjedhësi i Përfaqësueses, duke iniciuar procedure disiplinore, propozon pezullimin e lojtarit.

Ne rast të shqiptimit të masës së pezullimit, në bazë të rregullores disiplinore të FBK, lojtari i pezulluar nuk ka të drejtë lojë për Përfaqësuesen e as për klubin e tij, gjatë tërë kohës së pezullimit.

Neni 25

Përpos dënimit me mos lojë, për kundërvajtjen e vonës së paarsyeshme, mos përgjegjës për grumbullim dhe paraqitje në Përfaqësuese, lojtari mund të dënohet me të holla prej 500 deri në 3000 €.

Ne rast të mos pagesës së dënimit me të holla nga ana e lojtarit, komisar i garave mund të shqiptoj ndalesën me mos lojë të lojtarit, deri sa të paguhet cenimi i shqiptuar.

Neni 26

Për masën e pezullimit, masën e ndalesës për lojë ose dënimin me të holla njoftohet zyra e FIBA-së, nëse këtë e vlerëson të nevojshme Sekretari i Përgjithshëm i FBK, por patjetër kur është në pyetje lojtari që luan për ndonjë klub të jashtëm, ose është duke realizuar të drejtën e kalimit në klub të jashtëm.

Neni 27

Për përgatitje dhe lojë në Përfaqësuese, lojtarit i takon kompensimi për shpenzime të rrugës, shpenzimet e qëndrimit, dhe kompensimi ditor (dieta) në lartësi të përcaktuar me vendimin e bordit të FBK.

Neni 28

FBK e siguron pajisjen sportive për secilën Përfaqësuese për lojtarët, përzgjedhësin dhe shtabin profesional të Përfaqësueses. Te gjithë anëtarët e Përfaqësueses janë të obliguar t'i mbajnë pajisjet gjatë tërë kohës së aktivitetit të Përfaqësueses, të cilat i përcakton dhe siguron FBK.

Neni 29

Lojtarëve, përzgjedhësit dhe shtabit profesional mund t'i ndahen mirënjohje dhe shpërblime monetare, për rezultatet e arritura në gara. Lartësinë e shpërblimit e përcakton Bordi i FBK, kurse shpërblimet individuale iu propozon përzgjedhësi.

Bordi i FBK mund të vendosë të shpërblejë me të holla edhe persona tjerë për të cilët vlerësohet se janë meritore për suksesin e Përfaqësueses.

IV. DREJTORI, PERZGJEDHESIT DHE SHTABET PROFESIONALE TE PËRFAQËSUESESEVE

Neni 30

Drejtorin e Përfaqësueses e emëron dhe shkarkon Bordi i FBK. Drejtori mund të emërohet për ndonjë aktivitet konkret apo për një periudhë kohore-cikël. Periudha kohore mund të zgjat më së shumti 4 vite me të drejtë rizgjedhje pa kufizim.

Drejtori i Përfaqësueses është përgjegjës për të gjitha çështjet organizative, financiare dhe teknike të Përfaqësueses.

Drejtori bashkëpunon ngushtë me Sekretarin e Përgjithshëm të FBK dhe për punën e tij i përgjigjet Sekretarit dhe Bordit të FBK.

Në rast nevojë Drejtori mund të kërkojë që Bordi të emëroj zëvendës drejtor të përfaqësuesve për femra dhe përfaqësuesve për të rinj.

Me vendimin e bordit të FBK për emërimin e përzgjedhësit përcaktohet edhe statusi juridiko-punues i drejtorit, gjegjësisht përcaktohet nëse me Drejtorin do të bëhet kontratë për punë në kohë të caktuar apo kontratë mbi vepër.

Drejtori duhet të ketë:

- përvojë në basketboll si lojtarë ose trajnerë
- të ketë aftësi organizative dhe të marketingut
- të flasë së paku një gjuhë zyrtare të FIBA-s

Neni 31

Secila Përfaqësuese nga pika 4 e kësaj rregulloreje ka përzgjedhësin të cilin e emëron bordi i FBK me propozim të Këshillit profesional. Statusi, të drejtat dhe detyrat e përzgjedhësit, me përse afërmi përcaktohen me kontratë.

Neni 32

Përzgjedhësi emërohet për ndonjë aktivitet të Përfaqësueses, kualifikime, gara ose për ndonjë periudhë kohore-cikël. Me vendimin e Bordit të FBK për emërimin e përzgjedhësit përcaktohet edhe statusi juridiko-punues i përzgjedhësit, gjegjësisht përcaktohet nëse me përzgjedhësin do të behet kontratë për punë në kohë të caktuar apo kontratë mbi vepër.

Neni 33

Programet e punës detale të aktiviteteve të Përfaqësueseve të hartuara nga Këshilli Profesional në bashkëpunim me përzgjedhësin i miraton Bordi i FBK Këshilli Profesional dhe Drejtori mbikëqyrin realizimin e planeve të miratuara dhe programet e Përfaqësueses dhe për këtë informojnë Bordin e FBK. Listën e gjerë për çdo Përfaqësuese e përcakton Përzgjedhësi i Përfaqësueses me mbikëqyrjen nga Këshilli Profesional.

Neni 34

Pas përfundimit të aktivitetit të caktuar ose me propozimin e Këshillit profesional, përzgjedhësit janë të obliguar të paraqesin raport mbi aktivitetin e kaluar bordit të FBK. Para debatit për raportin e përzgjedhësit në Bordin e FBK, Këshilli Profesional jep raportin e vet. Nëse përzgjedhësi nuk plotëson ose nuk realizon programin detal të aktiviteteve, Bordi i FBK mund ta shkarkoj përzgjedhësin.

Neni 35

Përzgjedhësit dhe shtabet profesionale të Përfaqësueseve janë të obliguara t'i përmbahen Statutit të FBK, kësaj rregulloreje, rregullores së punës të këshillit profesional dhe akteve tjera të përgjithshme të FBK.

Neni 36

-Përzgjedhësit kryejnë këto punë:

-Bashkëpunojnë në hartimin e planit detal të aktivitetit të Përfaqësueses

-Përcaktojnë planin e aktiviteteve konkrete të Përfaqësueses,

-Propozojnë listën e gjerë të kandidatëve për çdo aktivitet dhe garë.

-Përcaktojnë listën e ngushtë të anëtarëve të Përfaqësueses për çdo aktivitet dhe garë,

-Në mënyrë profesionale udhëheqin stërvitjet dhe lojërat e Përfaqësueseve,

-Përgatisin plane dhe programe individuale për punë të anëtarëve të Përfaqësueseve nëpër klube dhe mbikëqyrin realizimin e tyre,

-Përcjellin përparimin ose zhvillimin e basketbollisteve të rinj, kandidatë potencialë për pjesë në punën e këshillit profesional,

-Paraqesin raport me shkrim për përgatitjet dhe lojërat, në afat prej 30 ditësh, pas përfundimit të përgatitjeve apo aktiviteteve dhe garave të mbajtura, për pjesë në punën e Bordit të FBK, dhe trupave të tjera të FBK kur shqyrtohen tema profesionale.

V.-PËRZGJEDHËSI I PËRFAQËSUESËS A (SENIOR)

Neni 37

-Përzgjedhësi i Përfaqësueses A (seniorë) të meshkujve zakonisht emërohet për periudhën katërvjeçare, por mund të emërohet edhe për kohe më të shkurtër në bazë të nenit 32 të kësaj rregulloreje.

-Për përzgjedhës të Përfaqësueses të meshkujve mund të përzgjidhet personi që përpos kushteve të përcaktuara me ligj, duhet t'i plotësojë edhe këto kushte:

-Se paku të këtë titullin e trajnerit të lartë të basketbollit,

-Të këtë rezultate të larta me klube të cilësisë së lartë,

-Të flasë njëhën nga gjuhët zyrtare të FIBA-së.

Neni 38

Përzgjedhësi i Përfaqësueses A të meshkujve mund të shkarkohet nga detyra edhe para skadimit të afatit kohor që është emëruar:

Nëse për shkak të jo efikasitetit të realizimit të planit kanë munguar rezultatet e pritura, për shkak të mosparaqitjes së raportit me shkrim pas përfundimit të aktivitetit të caktuar, ose pas kërkesës së këshillit profesional,

Nëse me veprimet e veta dëmton autoritetin e basketbollit kosovar, FBK e veçanërisht autoritetin e shtetit të Kosovës,

Për shkak të parapara me ligj ose kontrate në mes të përzgjedhësit dhe FBK-së.

Neni 39

Në rast të shkarkimit nga detyra të përzgjedhësit, të dorëheqjes ose në raste të tjera, Bordi i FBK-së me propozimin e Këshillit Profesional emëron ushtruesin e detyrës ose përzgjedhësin tjetër të Përfaqësueses A senior të meshkujve.

VI. PËRZGJEDHËSIT E PËRFAQËSUESËVE TJERA

Neni 40

Të gjithë Përzgjedhësit e Përfaqësuesve tjera sipas nenit 4 të kësaj Rregullore I emëron Bordi i FBK në bazë të propozimit të Këshillit Profesional.

Përzgjedhësit duhet të jenë:

- Trajnerë i licencuar në FBK
- Të jetë i dëshmuar më sukses në kategorinë gjegjëse
- Të jetë trajnerë me kualifikime të larta apo me shkollim superior të basketbollit
- të njohë së paku një gjuhë zyrtare të FIBA-s

Emërimi dhe shkarkimi i tij bëhet me kritere të njëjta si për Përzgjedhësin e Përfaqësueses së seniorëve.

VII.-SHTABET PROFESIONALE TE PËRFAQËSUESESEVE SHTETERORE

Neni 41

Përpos përzgjedhësit të Përfaqësueses s,nga pika 4 e kësaj rregulloreje, formohet shtabi profesional,ne te cilin hyje një ose me shumë trajnerë, mjeku dhe fizioterapeuti.

Përzgjedhësi i Përfaqësueses mund të kërkoj nga Drejtori i Përfaqësueses që t'i sigurohet bashkëpunëtori-trajneri me qëllim të grumbullimit të të dhënve për ekipet kundërshtarë dhe lojtaret e ndryshëm (skaut).

Neni 42

Anëtarët e shtabit profesional i emëron Bordi i FBK-se me propozimin e përzgjedhësit, mjekun dhe fizioterapeutin i emëron Drejtori i Përfaqësueses me rekomandimin paraprak të shoqatës së mjekësisë sportive që vepron në basketbollin kosovar.

Neni 43

Trajnerët dhe fizioterapeutet e Përfaqësueses bashkëveprojnë në punën e Përfaqësueses prej momentit të grumbullimit deri në përfundim të çfarëdo aktiviteti apo gare.

Mjeket e Përfaqësueses bashkëveprojnë në punën me Përfaqësuesen prej fillimit të garimit ose sipas nevojës,kurse me Përfaqësuesen A senior të meshkujve vepron prej momentit të grumbullimit të ekipit për aktivitet të veçante gjegjësisht garë të veçantë.

Mjeket dhe fizioterapeutët e Përfaqësueses bashkëpunojnë me mjekët dhe fizioterapeutët e klubeve, mbikëqyrin gjendjen shëndetësore dhe propozojnë trajtim shëndetësor të kandidatëve për përfaqësuese,si dhe mbajnë evidencën shëndetësore të tyre.

Neni 44

Përzgjedhësi ose anëtari i shtabit profesional i cili gjate punës me Përfaqësuese me veprimet e veta dëmton autoritetin e FBK ose basketbollit, mund që përveç dënimit kohor të kryerjes së detyrës në kohëzgjatje prej një viti, dënohet edhe me të holla në shumën prej 2000 deri në 5000 €.

Ndaj përzgjedhësit ose anëtarit të shtabit profesional Bordi i FBK-ës inicon procedurë disiplinore për dëmtimin e autoritetit të FBK-ës, ose basketbollit kosovar në tërësi.

Neni 45

Përzgjedhësve dhe anëtareve të shtabeve profesionale u takojnë kompensimet për shpenzime të rrugës, shpenzimet e qëndrimit dhe kompensimet ditore (dietat) në lartësi të përcaktuar me vendimin e Bordit të FBK-se.

VIII.-DELEGACIONI I FEDERATES SE BASKETBOLLIT TE KOSOVES DHE UDHEHEQESI I RRUGES

Neni 46

Për gara të ndryshme (kampionati evropian, lojërat olimpike ose aktivitete të ndryshme), Bordi i FBK-se mund të formojë delegacionin që përfaqëson FBK-ne para federatave tjera nacionale, në FIBA apo delegacioneve tjera.

Neni 47

Për anëtar të delegacionit Bordi i FBK-se mund të emërojë anëtarë të Kuvendit ose Bordit të FBK-se, punëtorë të basketbollit, ekspert të basketbollit të profileve të ndryshme, si dhe persona tjerë të cilët mund të kontribuojnë në rritjen e autoritetit dhe afirmimin e FBK-ës.

Neni 48

Për aktivitete ose gara të ndryshme për të cilat Bordi i FBK-se nuk ka emëruar delegacione, udhëheqësin e rrugës të Përfaqësuesve të ndryshme e përcakton Sekretari i Përgjithshëm i FBK-se.

Udhëheqësi i rrugës përcaktohet, pavarësisht a luan Përfaqësuesja në vend apo jashtë vendit. Përpos udhëheqësit të rrugës Sekretari i Përgjithshëm mund të përcaktojë edhe një person tjetër në udhëheqësi të rrugës kur kjo paraqet afirmim për FBK-ne.

VIII.-SIGURIMI I ANETAREVE TE PËRFAQËSUESES

Neni 49

Lojtarët,përzgjedhësit dhe anëtarët e shtabeve profesionale gjate kohës se përgatitjeve ose te garave te Përfaqësueseve te ndryshme,FBK i siguron ne njëren nga kompanitë e sigurimeve nga rreziku prej lëndimeve ose fatkeqësive.

Kontratën për sigurimin e personelit nga pika 1 e këtij neni,e nënshkruan Sekretari I Përgjithshëm i FBK-se me kompanitë me kushte me te volitshme.

IX.-DISPOZITAT E PERGJITHSHME

Neni 50

Bordi i FBK-se përmes udhëzimeve përcakton:

Standardet për te gjitha Përfaqësueset për numrin e lojtareve, shtabet profesionale, numrin e anëtarëve te Përfaqësueses, numrin e ditëve për përgatitje, vendosjen, stërvitjet, transportin,llojin e pajisjeve sportive, etj.

Udhëzimet i propozon Bordit Drejtori i përfaqësueses në bashkëpunimin me Përgjegjësën financiar të FBK.

Neni 51

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj rregulloreje bëhen ne mënyre dhe procedure sikur me rastin e miratimit te saj.

Interpretimin e kësaj rregulloreje e bënë Bordi i FBK-se.

Neni 52

Rregullorja hyn ne fuqi ditën e miratimit.

Prishtinë, 27. 09. 2011

Sekretari i Përgjithshëm
Nazmi Paçarada

Kryetari i FBK
Fatmir Gashi